

Në bazë të nenin 55 paragrafit 1 të Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08. 167/10 dhe 51/11 dhe Zyrtare Gazeta e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19 dhe 110/19) dhe neni 78 pika 8 nga Ligji për Arsimin Fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i Arsimit dhe Shkencës përcaktoi,

PROGRAMIN PËR KËSHILLIM TË NXËNËSVE NË SHKOLLAT FILLORE DHE PRINDËRIT/KUJDESTARËT E TYRE

1. Baza fillestare për përgatitjen e Programit

Shkolla fillore ndërmerr aktivitete për avancimin e mirëqenies të nxënësve në përputhje me qëllimet edukativo-arsimore dhe rezultatet e pritura të përcaktuara në programet mësimore. Përkundër kësaj, numër i caktuar i nxënësve, për arsye të ndryshme, gjatë vitit shkollor manifestojnë sjellje që nuk janë në përputhje me kodin e vendosur të mirësjelljes ose nuk arrijnë suksesin që sipas aftësive të tyre mund ta arrin. Për ata nxënës dhe prindërit/kujdestarët e tyre, shkolla ofron lloj mbështetjeje të veçantë përmes punës së fokusuar. Në çrast, është veçanërisht e rëndësishme puna këshilluese e bashkëpunëtorëve profesional me nxënës dhe prindër/kujdestarë.

Ky lloj i mbështetjes së nxënësve dhe prindërve është e rregulluar me nenin 76 dhe 77 të Ligjit për Arsimin Fillor ndërsa realizohet sipas Programit për këshillimin e nxënësve dhe prindërve, përkatësisht kujdestarëve, të sjellur nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

1.1 Baza profesionale për përgatitjen e Programit

Bashkëpunimi i shkollës me prindërit/kujdestarët është faktor i rëndësishëm për zhvillimin socio-emocional të nxënësve dhe formimi i qëndrimit pozitiv ndaj shkollës dhe mësimi. Rezultatet e hulumtimeve të shumta ¹ kanë treguar se niveli i lartë i pjesëmarrjes dhe angazhimit të prindërve në procesin edukativo-arsimor korespondon pozitivisht me përmirësimin e arritjeve akademike, nivelin më të lartë të suksesit në mësim, qëndrimet

¹ Deslandes, 2005; Epstein, 1995, 2001; Epstein & Salinas, 2004; Ferguson et al., 2008; Henderson & Mapp, 2002; HooverDempsey et al., 2005; Radu, 2011; Wright & Stegelin, 2003; Xu & Filer, 2008

pozitive të nxënësve ² ndaj shkollës, nivel më të lartë i aspiratat të tyre arsimore, përmirësimi i aftësive sociale të nxënësve.

Në bazë të rezultateve dhe përvojave të këilla, ndërtimi dhe kultivimi i marrëdhënieve të relacioneve në partneritet me prindërit/kujdestarët është inkorporuar në parimet mbi të cilat bazohet arsimi fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Prindërit/kujdestarët janë të përfshirë në shumë fusha të punës së shkollës, nga krijimi i politikave dhe administrimi i shkollës, deri te marrja e vendimeve të përbashkëta në lidhje me mësimin e fëmijës së tyre. Bashkëpunimi me prindërit është planifikuar me Programin për Bashkëpunim me Prindër, i cili është pjesë e Programit Vjetor të Punës së shkollës. Ai përfshin informimin e tyre për mësimin, përparimin, rregullsinë dhe sjelljen e fëmijës së tyre dhe edukimin dhe mbështetjen e prindërve/kujdestarëve për rolin e tyre prindëror, si dhe zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës. Bashkëpunimi me prindërit/kujdestarët është pjesë e punës të kuadrit edukativo-arsimor. Mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesional dhe drejtorët posedojnë kompetenca që ky bashkëpunim profesionale të organizohet dhe ta realizohet.³

1.2 Bazat normative për përgatitjen e Programit

Përcaktimi i sigurisë të mirëqenies dhe përparimin e të gjithë nxënësve është i përmbajtur në të gjitha dokumentet normative kyçe për arsimin fillor.

Këshillimi i prindërve/kujdestarëve është i rregulluar në mënyrë specifike me Ligjin për Arsimin Fillor.

Në Ligjin ⁴ rregullohen procedura, mënyrën e këshillimit dhe cilët prindër/kujdestarë i referohen për këshillim.

Sipas Ligjit, ministri i Arsimit sjell Programin për këshillimin e nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve me propozim të Shërbimit Pedagogjik.

² Во понатамошниот текст, заради рационалност на текстот, терминот ученик ќе се користи за двата рода

³ Закон за наставниците и стручните соработници во основните и средните училишта, Сл. весник на РСМ, бр. 161 од 5.08.2019, Правилник за професионални компетенции за директор на основно училиште <https://mon.gov.mk/stored/document/Pravilnik%20za%20profesionalni%20kompetencii%20za%20direktor%20na%20osnovno%20uciliste.pdf>

Правилник за основните професионални компетенции на наставниците во основните и средните училишта по подрачја https://mon.gov.mk/stored/document/06_Pravilnik-za-osnovni-profesionalni-kompetencii-za-nastavnici_18_02_20....pdf

Правилник за основните професионални компетенции по подрачја на стручниот соработник во основните и средните училишта https://mon.gov.mk/stored/document/07_Pravilnik-za-osnovni-kompetencii-strucen-sorabotnik_13_02_2020.pdf

⁴ Закон за основно образование, Службен Весник на Република Северна Македонија бр. 161, 5 август 2019, чл. 76, 77 и 78

Në Ligjin për Shërbimin Pedagogjik rregullohen kompetencat e Shërbimit Pedagogjik lidhur me këshillimin e prindërve.⁵

Në Konceptin për arsimin fillor,⁶ në pjesën "Sigurimi inkluziv" është theksuar se arsimi fillor është projektuar dhe organizuar për të siguruar regjistrimin, përfshirjen dhe përfundimin e arsimit fillor të të gjithë fëmijëve, në mënyrë sistematike të ndiqet përparimi i të gjithë nxënësve dhe të kujdesen "asnjë fëmijë të mos lihet pas."

Sipas Ligjit për Inspektim arsimor, Inspektorati Shtetëror i Arsimit është përgjegjës për evaluimin integral të institucioneve edukativo-arsimore, i cili përfshit punën e përgjithshme të shkollave.⁷ Në dokumentin "Indikator i për cilësinë e punës së shkollave fillore", përfshihen indikatorët të cilët i referohen mbështetjes së nxënësve që nuk arrijnë qëllimet edukativo-arsimore dhe këshillimit të prindërve/kujdestarëve. Ato përmbahen kryesisht në Fushën 2 – Arritjet e nxënësve dhe kanë të bëjnë me mbajtjen/braktisjen e nxënësve dhe në Zonën 5 – Klima e shkollës dhe kanë të bëjnë me klimën e shkollës dhe marrëdhëniet në shkollë.⁸

Këshillimi i prindërve/kujdestarëve realizohet nga psikologu i shkollës. Nëse në shkollë nuk ka të punësuar psikolog, këshillimin mund ta realizoj petagogu i shkollës, në përputhje me kompetencat e tij.

1.3 Qëllimi i programit

Programi i Këshillimit të Nxënësve dhe Prindërve/Kujdestarëve ka për qëllim të avancojë mirëqenien e nxënësve dhe t'i ndihmojë të arrijnë rezultatet të parashikuara për mësim nga programet mësimore, nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme të nxënësve dhe përfshirjes së duhur të prindërve/kujdestarëve. Efektet e këshillimit do të manifestohen nëpërmjet përmirësimit të rregullsisë në mësimdhënie, suksesit dhe sjelljes.

1.4 Nxënësit dhe prindërit/kujdestarët me të cilët realizohet këshillimi

Shkollat rregullisht e ndjekin mësimin, përparimin, sjelljen dhe rregullsinë e të gjithë nxënësve. Në këtë mënyrë, kontribuohet që të sigurohet mjedis stimulues për avancimin

⁵ Закон за Педагошка служба, чл.4, Службен весник на РМ бр. 18/2011, 41/2014, 55/2016 и 64/2018

⁶ Концепција за основно образование, донесена со решение бр. 08-3980/1 од 3.03.2021, <https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20MK.pdf>

⁷ Закон за Просветната инспекција, Сл. весник на РМ бр. 52/2005, 81/2008, 148/2009, 57/2010, 51/2011, 24/2013 и 137/2014

⁸ Индикатори за квалитетот на работата на основните училишта, ДПИ, 2019, <https://dip.gov.mk/integralna-evaluacija/indikator-i-za-kvalitetot-na-vospitno-obrazovniot-procjes-vo-osnovnite-i-srednite-uchilishta/>

dhe mirëqenien e tyre. Për disa nxënës është e nevojshme mbështetja më intensive që përfshin edhe këshillimin e nxënësve dhe të prindërve/kujdestarëve të tyre. Këshillimi i prindërve/kujdestarëve i referohet prindërve/kujdestarëve dhe fëmijëve të tyre që kanë nevojë për mbështetje shtesë në raport të suksesit shkollor dhe përparimit, rregullsisë dhe/ose sjelljes. Obligim profesional dhe ndarja shoqërore është secila nga ata nxënës të marrë mbështetjen e duhur për progres optimal akademik dhe zhvillim socio-emocional. Prandaj, këshillimi i prindërve/kujdestarëve të atyre nxënësve paraqet lloj këshillimi specifik.

Prindërit/kujdestarët e nxënësit tthirren në këshillim nëse nxënësi:

- ndjek mësimin në mënyrë të parregullt për arsye të paarsyeshme, përkatësisht ka më shumë se 10 mungesa të paarsyeshme;
- ka sukset të pakënaqshëm (tre ose më shumë nota të dobëta në fund të tremujorit ose gjashtëmujorit) ose sukcesi i tij ka është ulur në krahasim me notën e tremujorit paraardhës ose në krahasim me vitin e kaluar shkollor;
- Manifeston forma të ndryshme të sjelljes së papërshtatshme.

Krahas këshillimit të prindërve/kujdestarëve, si pjesë e domosdoshme e mbështetjes, realizohet edhe këshillimi me fëmijët e tyre, përkatësisht me nxënësit.

Psikologët, gjegjësisht pedagogët realizojnë këshillim me prindërit/kujdestarët nëse takimet e mëparshme të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të paraleleve me prindërit nuk kanë sjellë përmirësim e gjendjes.

Këshillimi i nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve mund të organizohet me iniciativën e psikologut/pedagogut të shkollës, ose me kërkesën e prindit/kujdestarit.

2. Parimet e punës

Me qëllim këshillimi i suksesshëm dhe të përshtatshëm të nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve, është e nevojshme që psikologët/pedagogët që realizuan këshillimin të kenë kompetencat e duhura dhe të udhëhiqen nga parime të caktuara.

Interesi më i mirë i nxënësit - Psikologët/pedagogët gjatë zgjedhjes të aktiviteteve të duhura për mbështetje për nxënësit dhe prindërit/kujdestarët udhëhiqen gjithmonë nga interesi më i mirë i nxënësit, në përputhje me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.⁹ Në situatat kur interesi i nxënësve bie ndesh me interesat e të rriturve, gjatë këshillimit udhëhiqet nga ajo që është në interesin më të mirë për nxënësit. Kohëzgjatja – Psikologët/pedagogët konsiderojnë se ndërhyrja në kohë në punën me nxënësit dhe prindërit/kujdestarët mund të japin rezultate të përshtatshme, para problemeve me të mësuarit dhe sjelljes së eskaluar.

Prandaj, ata përpiqen në shkollë të vendosin sistem për të parandaluar parregullsitë, dështimet dhe sjelljet joadekuate të nxënësve dhe për të vendosur komunikim të rregullt me udhëheqësit e paraleleve dhe punonjësit e tjerë të shkollës. Qëllimi i kësaj qasjeje është zvogëlimi i numrit të nxënësve për të cilët duhet të organizohet këshillimi, përkatësisht zgjidhja në kohë e problemeve të caktuara me të cilat ballafaqohen nxënësit në procesin edukativo-arsimor.

Këshillimi i nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve në rastet kur bëhet fjalë për një problem akut realizohet sa më shpejt që të jetë e mundur pas konstatimit të problemit.

Fokusimi i problemit

– Në këshillimin e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, psikologët/pedagogët fokusohen në situata aktuale për zgjidhjen e së cilës kryhet këshillimi. Problemi mund të jetë akut (p.sh. një incident serioz i sjelljes së parregullt) ose kronik (p.sh. mungesa të shpeshta të paarsyeshme nga mësimi). Ata janë të bindur se vetëm fokusimi në problemin specifik, në periudhë të caktuar më të gjatë ose më të shkurtër, për të gjithë të përfshirë në këshillim mund të japë rezultatet më të mira.

Tërësia dhe njohja e kontekstit familjar – Psikologët/pedagogët besojnë se një vlerësim i plotë i situatës dhe kontekstit familjar në të cilin ndodhet nxënësi është i rëndësishëm për suksesin e këshillimit. Ai i referohet kuptimit gjithëpërfshirës të nevojave dhe dëshirave, kapaciteteve dhe aftësive personale, përvojave dhe qëllimeve të vendosura nga nxënësi dhe prindi/kujdestari. Në punën me prindërit/kujdestarët, psikologu/pedagogu përshtat mënyrën e komunikimit me mjedisin social-kulturor dhe situatën familjare.

⁹ https://www.unicef.org/northmacedonia/media/1806/file/MK_CRC_1990_MK.pdf

Empatia – Psikologët/pedagogët janë të bindur se shprehja e empatisë është e një rëndësie kyqe për krijimin e marrëdhënieve ndërpersonale, mirëkuptimin reciprok dhe besimin reciprok. Duke u nisur nga kompleksiteti i situatës që lidhet me familjen, shëndetin socio-emocional i nxënësit etj., ata qasen me mirëkuptim gjatë komunikimit me nxënësit dhe prindërit/kujdestarin. Gjatë komunikimit, ata u mundësojnë nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve të shprehin perceptimet e tyre për situatën dhe propozimet që rezultojnë për tejkalimin e sfidës me të cilën po përballen pa u imponuar qëndrimin të tyre.

Konfidencialiteti – Puna këshilluese me nxënësit dhe prindërit/kujdestarët mund të sjellë informata konfidenciale për nxënësin, familjen dhe/ose mësuesin. Me veprimet e tyre, psikologët/pedagogët do të kontribuojnë që nxënësit dhe prindërit/kujdestarët të dinë se informatat e tilla nuk do të keqpërdoret dhe të fitojnë me besimin për shkëmbimin e të gjitha informatave që mund të jenë relevante gjatë këshillimit. Konfidencialiteti është parim që mund të shkelet vetëm në kushte të jashtëzakonshme (p.sh. kur moszbulimi i informacionit mund të çojë në cenimin të shëndetit fizik dhe/ose psiqik të njërit prej pjesëmarrësve në proces).

Profesionalizmi – Punën e tyre Psikologët/pedagogët e kryejnë në kuadër të kompetencave të tyre profesionale, standardeve për sjelljen profesionale dhe kodin e shkollës. Nëse gjatë procesit të këshillimit konstatojnë se zgjidhja e situatës eksistuese del nga kornizat e kompetencave të tyre, ata realizojnë, bashkëpunojnë me institucione të tjera kompetente dhe persona profesinal. Gjatë këshillimit, psikologët/pedagogët udhëhiqen nga parimet e integritetit dhe objektivitetit profesional.

3. Akses në punë këshilluese me nxënës, prindër/kujdestarë

Në këshillimin e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, psikologët/pedagogët aplikojnë këshillimin individual dhe/ose grupor, në varësi të personalitetit dhe moshës së nxënësit, llojit, kompleksitetit të problemit dhe specifikës së mjedisit.

Këshillimi individual realizohet në rastet kur arsyet e këshillimit përfshijnë një person/familje. Karakteristikat e këshillimit individual janë ato: mund t'i përshtatet dhe prindi/kujdestari specifik, komunikimi ndërmjet prindit/kujdestarit dhe bashkëpunëtorit profesional është më i hapur, sigurohet konfidencialitet më i madh; më lehtë të sigurohet afati kohor i këshillimit dhe përshtatshmëria e afateve dhe kohëzgjatjes.

Këshillimi në grup realizohet me një grup më të vogël ose më të madh nxënësish ose prindërish/kujdestarësh, fëmijët e të cilëve janë ballafaquar me një problem që është i zakonshëm (p.sh. prishja e rendit të shtëpisë, braktisja e shkollës në grup) ose është i pranishëm në një grup nxënësish (p.sh. sukses i pakënaqshëm me një numër të madh nxënësish në një lëndë të caktuar në një paralele). Ky lloj këshillimi realizohet edhe kur

natyra e problemit lidhet me marrëdhëniet në grup ose marrëdhëniet e individëve me grupin, si dhe në rastet kur koheziviteti i grupit mund të kontribuojë në tejkalimin e situatës dhe kur grupi duhet të arrijë marrëveshje të përbashkët dhe të marrë përgjegjësi.

Këshillimi në grup mund të realizohet përmes disa formave të punës në grup (shembull: punëtori, diskutime, prezantime). Përbërja e grupit, dinamika dhe kohëzgjatja e takimeve të grupit do të varen nga lloji dhe kompleksiteti i situatës. Vlerësimi për këtë bëhet nga psikologu në bashkëpunim me bashkëpunëtor tjetër profesional, mësimdhënës ose drejtori.

Në këshillimin e nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve mund të kombinojnë të dyja qasjet.

4. Përmbajtje për këshillim individual dhe grupor

Përmbajtja dhe temat për këshillim individual dhe grupor lindin nga sfidat që lidhen me të mëxuarit dhe sjelljen e nxënësve, në kontekstin e zhvillimit/periudhës zhvillimore të tyre shoqërore, emocionale dhe njohëse që kalojnë dhe klimës së përgjithshme të shkollës.

Për sa i përket përmbajtjes, këshillimi më së shumti i referohet përballjes me sfidat me të cilat përballen nxënësit në kategoritë në vazhdim:

Marrëdhëniet ndërpersonale – krijimi i marrëdhënieve shoqërore, respektimi i normave të sjelljes, zhvillimi i aftësive komunikuese, nevoja për vëmendje, përballja me presionin social, përballja me dhunën e bashkëmoshatarëve dhe zgjidhjen e konflikteve;

Konteksti shkollor – vështirësi në përvetësimin e përmbajtjes mësimore, ulje e motivimit për të mësuar, formimi i qëndrimit pozitiv ndaj të mësuarit, ngritja e aspiratave arsimore, frika nga pyetja, planifikimi i kohës, përballja me detyrat dhe detyrat e shkollës, problemet me disiplinën;

Konteksti familjar – marrëdhëniet me prindërit/kujdestarët, vëllezërit e motrat, pritshmëritë e tepërta të prindërve/kujdestarëve, ndryshimet në strukturën e familjes, dhuna në familje, sjelljet e rrezikshme në familje, (mos)respektimi i karakteristikave zhvillimore dhe personale të fëmijës në familje. ;

Konteksti interpersonal- kriza e identitetit, vetë-imazhi dhe forcimi i vetëvlerësimit, vetëdija e ulët, vetërregullimi emocional, përshtatja në mjedisin shkollor, ankthi, gjendja depresive, vetëpranimi, vetëdëmtimi, mendimet për vetëvrasje, forma të ndryshme të sjelljes së rrezikshme.

Prandaj, linden temat që mund të diskutohen në takimet këshilluese. Gjatë zgjedhjes së temave, bashkëpunëtorët profesional udhëhiqen nga situatat dhe sfidat specifike në shkollë dhe mund të përdorin programe ekzistuese dhe burime të dobishme, si programe për mbështetje psikosociale dhe avancimin e shëndetit mendor, programe për prindërim pozitiv, udhëzime për trajtimin e dhunës dhe të tjera.¹⁰

5. Procedurat për këshillimin e nxënësve, prindërve/kujdestarëve

Sfidat me suksesin, rregullsinë dhe sjelljen shpesh ndodhin tek të njëjtët nxënës gjatë një periudhe më të gjatë, madje edhe gjatë disa viteve shkollore. Duke e pasur parasysh që mësimdhënësit dhe udhëheqësit e paraleleve janë në një marrëdhënie të përditshme me nxënësit, ata mund të jenë të parët që vërejnë ndryshimet që ndodhin tek nxënësit dhe të ndërmarrin veprime fillestare në përputhje me rrethanat.

Kur aktivitetet e ndërmarra nga mësimdhënësit me nxënësit dhe prindërit/kujdestarët e tyre nuk kanë dhënë rezultat, këshillimi organizohet dhe kryhet nga psikologu/pedagogu në shkollë.

5.1 Aktivitete me nxënës dhe prindër/kujdestarë të realizuara nga mësimdhënësit

Mësimdhënësi dhe udhëheqësit e paraleleve konform kompetencave të tyre për punë me nxënës dhe bashkëpunim me prindërit, realizojnë këshillim me nxënësit dhe prindërit/kujdestarët e tyre, individualisht ose në grup. Për rastet kur aktivitetet e ndërmarra nga mësimdhënësit dhe drejtuesit e paraleleve nuk japin rezultate

(komunikim i pamjaftueshëm me prindërit, nuk bashkëpunojnë për tejkalimin e situatës, nuk ka përmirësim në sjelljen, suksesin apo rregullsinë e nxënësve), udhëheqësit e paraleleve informojnë me gojë ose me shkrim psikologun e shkollës. Njëkohësisht udhëheqësi i paraleles /mësimdhënësi e informojnë bashkëpunëtorin profesional për aktivitetet e ndërmarra.

¹⁰ Trajnim online për mbështetje psikosociale dhe promovim të shëndetit mendor (vetëm për përdoruesit e regjistruar, me hyrje në Eduino); Materiale trajnuese për mbështetje psikosociale dhe promovim të shëndetit mendor; Prind fer , fëmijë fer [Burimi elektronik] : manual për prindërimin pozitiv; Udhëzime për procedurën e raportimit dhe mbrojtjes së nxënësit viktimë e çfarëdo forme dhune, abuzimi dhe neglizhimi, <https://mon.gov.mk/content/?id=3288>

Periudha kohore	Aktivitetet e ndërmarra nga mësime dhe udhëheqësit e paraleleve	Personat përgjegjës
Shtator	Kontrollon shkallën e përvetësimit të njohurive (paratest, teste përsëritje, fletë mësimi kuize të diturive)	mësime dhe udhëheqësit
	I kushton vëmendje të shtuar nxënësve me arritje më të ulëta	mësime dhe udhëheqësit e paraleles
	Informon nxënësit, prindërit/kujdestarët për rregullat e shtëpisë dhe kodekset e shkollës	udhëheqësi i paraleles
	Mban mbledhjen e prindërve për specifikat e punës në vitin aktual, synimet dhe vështirësitë e mundshme me të cilat mund të përballen nxënësit dhe jep udhëzime se si ata dhe shkolla mund të ndihmojnë në parandalimin dhe tejkalimin e tyre.	udhëheqësi i paraleles
Gjatë gjithë vitit shkollor	Ndjek arritjet dhe sjelljen e nxënësve dhe realizon biseda këshilluese me nxënës dhe prindër/kujdestarë	udhëheqësi i paraleles
	Punon për të motivuar nxënësi dhe për të rritur aspiratat e tyre arsimore	udhëheqësi i paraleles
	Informon psikologun, gjegjësisht pedagogun për nxënës/nxënësit që shkel kodekset e shkollës në rastet kur aktivitetet me nxënësit dhe prindërit/kujdestarët e ndërmarra nga mësime dhe udhëheqësit e paraleleve nuk kanë dhënë rezultate	udhëheqësi i paraleles
	Informon psikologun/pedagogun për mungesën e paarsyeshme në mësime	udhëheqësi i paraleles
Në fund të çdo tremujori	Informon psikologun/pedagogun për nxënësit që kanë arritur rezultate të pakënaqshme në tre ose më shumë lëndë ose rezultate dukshëm më të ulëta në krahasim me tremujorin e mëparshëm	udhëheqësi i paraleles

5.2 Këshillim nga psikologu gjegjësisht pedagogu

Këshillimi me prindërit/kujdestarët dhe fëmijët e tyre zhvillohet njëkohësisht me qëllim që të ofrohet kalim sistematik në njohurit e kontekstit eksistues ose kushtet, gjegjësisht situatë, dhe të gjenden forma përkatëse në mbështetjen e nxënësit dhe famlje.

Qëllimi i këshillimit të nxënësve është nxitja e zhvillimit të personalitetit të nxënësit, përmirësimi i mirëqenies së tij dhe përshtatja në mjedisin shkollor duke ndryshuar disa forma të sjelljes dhe duke parandaluar sjelljet e rrezikshme.

Qëllimi i këshillimit të prindërve/kujdestarëve është avancimi i njohurive , qëndrimet dhe aftësitë e tyre për të mbështetur zhvillimin e fëmijës së tyre. Varësisht natyrës së problemit dhe nevojave të nxënësit/nxënësve, psikologu/pedagogu vlerëson se cilën formë të këshillimit do të zbatojë (këshillim individual apo grupor).

5.2.1 Këshillimi individual i nxënësve

Këshillimi individual i nxënësve ofron një mundësi të drejtëpërdrejtë për komunikim, mbështetje dhe bashkëpunim të drejtëpërdrejtë dhe intensiv me nxënësin. Kjo është formë ndërveprimi ndërmjet psikologut/pedagogut të shkollës dhe nxënësit në të cilin ata:

- realizojnë marrëdhënie të besimit reciprok;
 - të punojnë së bashku, duke shprehur ide, mendime, ndjenja;
 - të identifikojë problemin;
 - së bashku të fitojnë njohuri për atë që po i ndodh nxënësit;
 - të shqyrtojnë mënyra dhe strategji për riorganizimin, avancimin e sjelljes së nxënësit;
- zbatojnë aktivitetet e dakorduara dhe vlerësojnë së bashku efektet.

Koha dhe kohëzgjatja e këshillimit planifikohet në marrëveshje me nxënësin dhe zgjat për aq kohë sa nxënësi ka nevojë për këtë lloj mbështetje.

Periudha kohore	Veprimtaritë e ndërmarra nga psikologu/pedagogu i shkollës
Nëse është e nevojshme,	diskutohet situata për të cilën nxënësi thirret për këshillim
	me nxënësin shkëmbehen informata të rëndësishëm dhe të dobishme për të kuptuar dhe përmirësuar/tejkualuar situatën

gjatë gjithë vitit shkollor	Diskutohen qasjet dhe strategjitë e mundshme për ballafaqimin me situatën, dakordohen për hapat e ardhshëm dhe kush duhet të përfshihet për të përmirësuar situatën
	nxënësi mbështetet dhe ndihmohet në procesin e ndryshimeve personale që duhet t'i ndodhin
	arrihet marrëveshje për mënyrën e ndjekjes të ndryshimeve në sjelljen e nxënësit dhe aktiviteteve të mbetura të përfshirë në proces pritet t'i zbatojnë ato (prindër, mësime, shokë të klasës, bashkëpunëtorë profesionistë, etj.)
	bëhet vlerësim efektiv i këshillimit

- 5.2.2 Këshillim individual i prindërve/kujdestarëve

- Këshillimi individual i prindërve nga psikologu/pedagogu në shkollë realizohet kur vlerësohet se përfshirja e prindërve/kujdestarëve është e domosdoshme për tejkalimin e një situatë të caktuar me qëllim që:
 - të shkëmbejë me prindërit/kujdestarët informacione për nxënësin që janë të rëndësishme për punën e mëtejshme me të ose janë të natyrës konfidenciale;
 - shpejt dhe në kohë të intervenohet pasi të lind problemi;
 - së bashku me prindin/kujdestarin të gjejnë mënyra efikase për përmirësimin e situatës;
 - të monitorojë sjelljen e nxënësit dhe të veprojnë në mënyrë parandaluese.

Numri, kohëzgjatja dhe koha e takimeve varen nga çdo rast specifik dhe bien dakord ndërmjet psikologut/pedagogut dhe prindit/kujdestarit.

Prindi/kujdestari ftohet në këshillim individual me telefon, e-mail ose me udhëheqësin e paraleles. Nëse prindi/kujdestari nuk i përgjigjet këshillimit individual pas dy thirrjeve radhazi, shkolla i dërgon atij një ftesë me shkrim të arkivuar (Formulari nr. 5).

Koha e realizimit	Aktivitetet e ndërmarra nga psikologu/pedagogu i shkollës
Sipas nevojës gjatë gjithë vitit shkollor	prindi/kujdestari i referohet këshillimit individual
	përkthehet situata dhe shpjegohet nevoja për këshillim
	me prindin/kujdestarin shkëmbehen informatat që janë të rëndësishme dhe të dobishme për përmirësimin/tejkalin e situatës.

vitit shkollor	diskutohen zgjidhjet e mundshme, bien dakord për hapat e ardhshëm dhe kush duhet të përfshihet për përmirësimin e situatës
	me prindin/kujdestarin shqyrtohet se çfarë ndihme dhe mbështetje duhet t'i jepet nxënësit
	identifikohen burimet ekzistuese dhe burimet e mbështetjes
	dakordohet mënyra e ndjekjes së ndryshimeve tek nxënësi dhe komunikimi i ardhshëm me prindin/kujdestarin
	ndjeken efektet e këshillimit

- 5.2.3 Këshillimi në grup i nxënësve

Këshillimi i nxënësve në grup realizohet kur psikologu/pedagogu vlerëson se grupi mund të ndikojë pozitivisht në nxitjen e ndryshimeve në sjelljen e nxënësve, përmirësimin e pozicionit të tyre në grup dhe/ose kur ka nevojë për psikoedukim për temë (çështje) specifike.

Kjo është formë e ndërveprimit ndërmjet psikologut/pedagogut të shkollës dhe grupit të nxënësve në të cilin ata:

- shkëmbejnë dhe ndajnë informacione, ide, mendime dhe ndjenja;
- zhvillojnë vetëdijen për rëndësinë e grupit dhe dinamikës së grupit;
- identifikojnë së bashku problemin dhe kuptojnë më mirë rolin e tyre në situatë;
- ata vënë në dyshim qëndrimet dhe vlerat e tyre;
- të negociojnë ndryshime në sjellje që do të rezultojnë në tejkalimin e situatës;
- të avancojnë aftësitë sociale.

Këshillimi në grup mund të realizohet me të njëjtin grup nxënësish disa herë, varësisht nga nevoja. Një takim në kuadër të këshillimit në grup duhet të zgjasë përafërsisht sa një orë mësimi, por nëse është e nevojshme edhe më shumë.

forma e këshillimit në grup	Aktivitetet e ndërmarra nga psikologu/pedagogu i shkollës
Këshillimi i nxënësve që shfaqin sjellje të ngjashme të rrezikshme	nxënësit njoftohen për kohën dhe hapsirën e realizimit të këshillimit në grup
	dakordohen për dinamikën e takimeve dhe rregullat e sjelljes në grup
	përshkruhet situata dhe arsyeja për të cilën thirren për këshillim

	ndahen informatata dhe pikëpamjet e situatës nga të gjithë pjesëmarrësit në këshillim
	Arrihet një marrëveshje për futjen e formave të ndryshme të sjelljes në drejtim të tejkalimit të situatës ekzistuese
	dakordohen që secili nga pjesëmarrësit në këshillim të marrë përsipër tejkalimin e situatës
	monitorohet realizimi i aktiviteteve dhe efektet e këshillimit.
Punëtori psikologjike/pedagogjike	nxënësit informohen për temën dhe kohën e mbajtjes së punëtorive
	grupet e nxënësve formohen sipas interesit dhe/ose nevojës për të marrë pjesë në punëtori të caktuara
	realizohen aktivitetet e planifikuara
	ndjeken dhe vlerësohen efektet e punëtorive

- 5.2.4 Këshillimi në grup i prindërve/kujdestarëve

Këshillimi në grup i prindërve/kujdestarëve kryhet në rastet kur:

- disa nxënës të së njëjtës paralele ose të së njëjtës klasë ose në nivel të gjithë shkollës shfaqin të njëjtën formë të sjelljes së rrezikshme;

- Më shumë prindër/kujdestarë do të tregojnë interes për një temë të caktuar që mund t'i ndihmojë ata të tejkalojnë problemet me të cilat përballen fëmijët e tyre.

Në rast se organizohet këshillim në grup për shkak të frekuentimit të parregullt të mësimit, uljes së suksesit ose shkeljes së rregullave të shtëpisë së shkollës nga nxënësit, prindërit/kujdestarët ftohen në këshillim me telefon, me postë me ftesë me shkrim, me postë elektronike.

Punëtoritë psikologjike/pedagogjike mund të jenë pjesë e programit të edukimit të prindërve dhe shkolla i informon prindërit për to në mbledhjet e prindërve, takimet individuale dhe këshillimet, tabelat e njoftimeve ose nëpërmjet faqes së internetit të shkollës.

forma e këshillimit në grup	Veprimtaritë e ndërmarra nga psikologu/pedagogu i shkollës
Këshillimi i prindërve/kujdestarëve kur disa nxënës nga e	ftohen prindërit/kujdestarët e këshillimit në grup (përmes udhëheqësve klasor ose personalisht)
	përshkruhet situata dhe arsyeja pse thirren për këshillim

njëta paralele ose e njëta klasë ose në nivel shkolle shfaqin sjellje të ngjashme të rrezikshme	me prindërit/kujdestarët informacionet dhe pikëpamjet për situatën shkëmbehen nga të gjithë pjesëmarrësit në këshillim
	diskutohen zgjidhjet e mundshme të situatës
	identifikohen burimet ekzistuese dhe burimet e mbështetjes
	dakordohen që secili nga pjesëmarrësit në këshillim të marrë përsipër tejkalimin e situatës
	ndjeket realizimi i aktiviteteve dhe efektet e këshillimit
Punëtori psikologjike/pedagogjike	prindërit/kujdestarët informohen për temën dhe kohën e punëtorive psikologjike
	grupet e prindërve/kujdestarëve formohen sipas nevojës apo interesit për një punëtori të caktuar
	realizohen punëtoritë e përzgjedhura
	kryhet një vlerësim i efekteve të punëtorive

6. Evidencë të aktiviteteve të ndërmarra dhe rezultateve të arritura

Për zbatimet e seancave individuale të këshillimit me nxënës dhe prindër/kujdestarë në Formularin 1 – Formulari për këshillim individual me nxënës dhe Formularin 2 – Formulari për këshillim individual me prindërit/kujdestarët.

Formulari 1 përmban të dhëna për nxënësin, lëndën e këshillimit/situatën për të cilën nxënësi është thirur në këshillim, informacione të dobishme për tejkalimin e problemit, aktivitetet (hapat) e dakorduar për tejkalimin e problemit, procesin e mbështetjes së nxënësit (ndihmë për të bërë ndryshime personale tek nxënësit, ndjekjen e ndryshimeve tek nxënësi dhe efektet nga këshillimi. Për çdo cikël të këshillimit individual plotësohet një formular. Në pjesën e Procesit të Mbështetjes së Nxënësve, për çdo takim individual, shënohet data, mbështetjen e cila është ofruar (aktivitetet) dhe nënshkrimi i nxënësit.

Formulari 2 përmban të dhëna për prindin/kujdestarin dhe nxënësin, lëndë e këshillimit/situatës për shkak të cilës prindi është thirur për këshillim, informacione të dobishme për tejkalimin e problemit, aktivitetet (hapat) e dakorduar për tejkalimin e problemit, procesin e mbështetjes së prindit dhe ndjekjen e ndryshimeve dhe efekteve të këshillimit. Për çdo cikël të këshillimit individual plotësohet një formular. Në pjesën e Procesit të Mbështetjes së Prindërve, për çdo takim individual, shënohet data, mbështetjen e cila është ofruar (aktivitetet) dhe nënshkrimin e prindit/kujdestarit.

Për zbatimet e këshillimit grupor me nxënës dhe prindër/kujdestarë mbahet evidencë në Formularin 3 – Formulari për këshillim grupor me nxënës dhe Formulari 4 – Formulari për seancat e këshillimit grupor me prindërit/kujdestarët.

Formulari 3 përmban: arsyen e këshillimit, lëndën e këshillimit/problemin i cili është zgjidhur, informacione të tjera relevante, rrjedhë e këshillimit, aktivitetet e dakorduara dhe efektet nga këshillimi. Për çdo cikël këshillimi grupor plotësohet një formular. Në pjesën e rrjedhës së këshillimit, për çdo takim grupor, shënohet data dhe përmbajtja e këshillimit. Në përbërje të Formularit 3 është lista e nxënësve të pranishëm - emrin dhe mbiemrin e nxënësit, paralelën, datën e mbajtjes së secilit prej takimeve dhe nënshkrimin e nxënësit për çdo takim.

Formulari 4 përmban: arsyen e këshillimit, lëndën e këshillimit/problemin i cili është zgjidhur, informacione të tjera relevante, rrjedhë e këshillimit, aktivitetet e dakorduara dhe efektet nga këshillimi. Për çdo cikël këshillimi grupor plotësohet një formular. Në pjesën e rrjedhës së këshillimit, për çdo takim grupor, shënohet data dhe përmbajtja e këshillimit. Në përbërje të Formularit 4 është lista e prindërve/kujdestarëve të pranishëm - emrin dhe mbiemrin e prindit/kujdestarit, mbiemrin dhe klasën e nxënësit, datën e mbajtjes së secilit prej takimeve dhe nënshkrimin e prindit/kujdestarit për çdo takim.

Në rastet kur prindi/kujdestari nuk i është përgjigjur këshillimit pas tre ftesave radhazi dhe në rastet kur të gjitha aktivitetet e dakorduara dhe të ndërmarra për këshillimin e nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve nuk kanë dhënë rezultat dhe nuk ka përmirësim të situatës, shkolla me shkresë zyrtare i njofton shërbimet të cilët janë përgjegjës për situatën konkrete, siç janë: Shërbimi pedagogjik, inspektori arsimor i autorizuar, inspektorati shtetëror i arsimit, qendra për punë sociale. Në shkresën deri tek institucioni kompetent arsyetohet situata dhe të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga shkolla me kërkesë për të siguruar mbështetje adekuate nga institucioni në kuadër të kompetencave të tyre.

Në fund të çdo viti shkollor, shkolla kryen analizë të efekteve të këshillimit të nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve, e cila është pjesë përbërëse e raportit vjetor për punën e shkollës. Rezultatet e analizës përdoren për avansimin e praktikave të këshillimit për nxënësit dhe prindërit/kujdestarët.

Formulari 5 përmban të dhëna me emrin e shkollës, numrin e ftesës, emrin dhe mbiemrin e prindit/kujdestarit i cili ftohet dhe nxënësin dhe në cilën klasë dhe paralele mëson; arsyen për të cilën është ftuar prindi/kujdestari; njoftim për detyrimin ligjor për këshillim; si duhet të veprojë prindi/kujdestari në rast se nuk merr pjesë në këshillim; vërejtje për pasojat për prindin/kujdestarin për shkak të mungesës së këshillimit; datën e lëshimit dhe nënshkrimi

të udhëhqësitë të njësis dhe drejtorit të shkollës. одделенскиот раководител и директорот на училиштето.

7. Ky Program hyn në fuqi në ditën e përcaktimit.

12-06-2023

26-1621/

Nr.



Министер за образование и наука,

Ministëri Arsimit dhe Shkencës,

Doc. Dr. Jeton Shaqiri

Formulari nr. 1

Shkolla fillore komunale _____

**Formular
për këshillim individual me nxënësit**

Emri dhe mbiemri i nxënësit dhe paralele		
Lënda e këshillimit/ situatës për shkak të cilës nxënësi ftohet në këshillim:		
Informacione të dobishme për të tejkaluar problemin:		
Aktivitetet (hapat) e dakorduar për tejkalimin e problemit:		
Proces në mbështetje të nxënësit (ndihmë për të sjellë ndryshime personale tek nxënësi)		
Data	Aktivitete	Nënshkrim i nxënësit
Ndjekjen e ndryshimeve tek nxënësi		
Efektet e këshillimit:		

Realizues i këshillimit _____

Formulari nr.2

Shkolla fillore komunale _____

Formular
për këshillim individual me me prindin/kujdestarin

Emri dhe mbiemri i prindit		
Emri dhe mbiemri i nxënësit dhe paraleles		
Lëndë e këshillimit/situatës për shkak të cilës ftohet në këshillim prindi/kujdestari:		
Informacione të dobishme për të tejkaluar problemin:		
Aktivitetet (hapat) e dakorduar për tejkalimin e problemit:		
Proces në mbështetje të prindit/kujdestarit		
Data	Aktivitete	Nënshkrim i prindit/kudjestarit
Ndjekjen e ndryshimeve:		
Efektet e këshillimit:		

Realizues i këshillimit _____

Formulari nr.3

Shkolla fillore komunale _____

Formular
për këshillim grupor me nxënësit

Arsyeja për këshillim:

1. Sjellje e papërshtatshme
2. Suksesi i zvogluar në shkollë
3. Pjesëmarrje jo e rregullt në mësimet (mungesa të parsyeshme)

Lënda e këshillimit/problemi i cili është zgjidhur:

Informacione të tjera relevante:

Rrjedhë e këshillimit

Data	Përmbajtja e këshillimit

Aktivitetet e dakorduara:

Efektet e këshillimit:

Realizues i këshillimit _____

Lista e nxënësve të pranishëm

Emri dhe mbiemri i nxënësit	Paralele	Data dhe nënshkrimi i nxënësit		

Formulari nr.4

Shkolla fillore komunale _____

Formular
për këshillim grupor me prindërit/kujdestarët

Arsyeja për këshillim: 1. Sjellje e papërshtatshme 2. Suksesi i zvogluar në shkollë 3. Pjesëmarrja e parregullt në mësimet (mungesë e të parsyeshme)	
Lënda e këshillimit/problemi i cili është zgjidhur:	
Informacione të tjera relevante:	
Rrjedhë e këshillimit	
Data	Përmbajtja e këshillimit
Aktivitetet e dakorduara:	
Efektet e këshillimit:	

Formulari 5

SHFK " _____ " komuna _____ qyteti
_____ dërgon

FTESË nr. _____

për këshillimin e prindërve/kujdestarëve

Ftohet në këshillim individual/grupor _____

prind/kujdestar i nxënësit _____ në klasën _____:

Këshillimi do të mbahet më _____ në orën _____ nga ana e psikologut/pedagogut të shkollës.

Prindi/kujdestari ftohet për këshillim për shkak të:

- ndjekjes jo të rregulltë të mësimit për arsye të paarsyeshme, gjegjësisht nxënësi/ja ka më shumë se 10 mungesa të paarsyeshme;
- rezultatit të pakënaqshëm (tre ose më shumë nota të dobëta në fund të tremujorit ose gjashtëmujorit) ose suksesi i nxënësit/ses është ulur ndjeshëm në raport me suksesin në tremujorin paraardhës ose në raport me vitin e kaluar shkollor;
- manifeston forma të ndryshme të sjelljes së papërshtatshme;
- të tjera.

Prindi/kujdestari është i detyruar ligjërisht të marrë pjesë në këshillim. Nëqoftëse nuk mund të marrë pjesë për arsye të paarsyeshme, është i obliguar të njoftojë udhëheqësin e paraleles ose psikologun/pedagogun përpara këshillimit ose në afat prej tre ditëve pas këshillimit.

Data _____

Udhëheqës/psikolog/pedagog i paraleles

Drejtori
